▼▼▼▼▼▼▼

Vera Istrefaj
VESË SHPIRTI

***

Redaktor
Gëzim Ajgeraj

***

Recensent
Ilam Berisha
Ibrahim Skenderi

***

Lektore
Autorja

***

Kopertina
Klevis Istrefaj

▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼▼

Vera Istrefaj

VESË SHPIRTI

Poezi

►◄

Botoi
METAFORA
Zvicër, 2016

POEZIA SI PIKËLIM I BRENDSHËM I SHPIRTIT POETIK

Poezia e autores Vera Istrefaj, nuk vuan nga e kaluara e errët, nga izolimi, diktaturat e sistemet të cilat njëherë e përgjithmonë kanë përfunduar mallkimit të kohë-shkuarës.

Por as vargun nuk e vë për asnjë çast në shërbim të sistemeve apo politikave ditore, të cilat një ditë do të përfundojnë si ajo e shkuara, ndërsa vargjet dhe poezia mbeten të përjetshme.

Zëri i brendshëm i saj, që shkrihet si pikëllim shpirtëror dhe pikëlon vargjeve, është burimi i muzës për fjalën, e cila pasqyron individualitetin krijues të saj dhe botën prej nga ajo gjithmonë niset me fjalën, për ta shkrirë në poezi.

Vargun e trajton si një dritë në vizion, që buron nga një ndjenjë e brendshme shpirtërore, e cila rrjedh pandalshëm dhe merr trajtat e komunikimit me publikun e gjerë, si një rreze që përhap dritë.

Falë këtij individualiteti, ajo tashmë në poezinë e saj ka ngritur stilin dhe botën krijuese, e cila e bën të dallueshëm me individualitetin e saj krijues.

Vera Istrefaj: VESË SHPIRTI, botoi: Metafora, Prizren, 2016

Vera Istrefaj, tashmë autore e disa librave me poezi, në vazhdimësi po shpalos vlera të artit letrar dhe të fjalës së bukur artistike, në poezi. Poezia, si shprehje dhe art i shpalosjes së ndjenjave të brendshme të botës njerëzore, në raport me jetën dhe kohën që jeton, autores i është bërë udhërrëfim kronik, brenda së cilës ajo paraqet ndjenjat dhe përceptimin e saj për jetën.

Nëpërmjet vargut të saj, ajo gjithnjë e më shumë, shpalos metafora të bukura, të cilat si tërësi në varg, japin peisazhe, shprehje, forma të prezantimit të gjërave, të cilat për kah akceptimi letrar, janë shumë të bukura: ***.../Dridhet zemra/si gjethe vjeshte / furtunave të shpirtit/... /Po fundosen ëndrrat/... IMAZH.***
Stili i metaforave, të cilat kjo poete i sjell, i takojnë metaforës brenda vargjeve, duke përdorur në vazhdimësi fjalorin e përditshmërisë së fjalëve.

Një formë shumë e pëlqyer dhe e aplikuar në poezinë e sotme moderne. Pra, autorja nuk vrapon pas fjalëve, por brenda vargjeve, ajo fsheh një botë të thellë metaforike, që vargut vibrojnë lehtazi metaforat e muzës së një mendimi po aq të thellë, por me akcent të lehtë të kapjes së tyre, nga lexuesi: ***... / Tutje darë e mendimit,/ librin e ëndërrave / mos ma shfleto! / S'po i gjej dot një varr/Trishtimit/.../ABSTRAKSION/***

Edhe libri "Vesë shpirti" që po vjen përpara lexuesit, vjen ndjeshëm, me ato vlerësime që u thanë më lart, por tani më me një profesionalizëm që brenda një finese të hollë të mendimit, shkrihet në vargje, një botë e tërë e poeteshës Vera Istrefaj.

Poezia si shprehje e mirëfilltë e mendimit

.../Në skërmitje dhëmbësh/akulli i kohës/

më mundon, / e zjarri i zemrës, bubulak / shkrumbon / Sa pak kërkoj nga jeta, / sa pak! / ... / E s`më ofron / Asgjë /.../ AKULLI I KOHËS/

Dihet mirëfilli se tani më kjo autore, ka disa libra me poezi, dhe me individualitetin e vet krijues dhe poezisë që e prezanton, ka hyrë në radhët e krijuesve të cilët gjithnjë e më shumë po dëshmojnë e po lënë emër në letrat shqipe.

Kjo dëshmi, është fakti se ajo në vazhdimësi po krijon dhe prezanton përpara lexuesit, botën shpirtërore të saj, përmes vargjeve të bukura e artistike.

Stuhisë së shpirtit tim
veç vargu në rrëfim

Dhe ky sukses i saj, e radhit atë në vlera të mirëfillta të vargut të krijuesve, që nuk i shkëputen artit, por jetojnë me të, pranë tij dhe e prezantojnë atë në vazhdimësi.

Poezia e Vera Istrefajt, si tërësi shpalos botën e njeriut tonë, të njësuar brenda artit të vargut, që si tërësi njësohet brenda metaforave të mendimit nga botëkuptimi i brendëshëm poetik.

Brenda këtij njësimi, e gjejmë kohën, krijuesin dhe hapësirën e saj dhe raportin me kohën. Dhe nga një botë individuale, vargu vjen e shndërrohet si mendim artistik, i kapshëm për realitetin shoqëror, të cilit i dedikohet. Megjithatë, përgjithësisht, poetja vargun e saj e nis nga brendia e vetë, si një shpalosje e brendshme individuale, pa ndonjë synim dhe personifikim të jashtëm.

Le t`i nisin fjalët / pranga për to s`kam / Po më rimon shpirti / si ky shi mbi xham / Vargu fluturon / Petal më petal / Me rrezet e shpirtit / ngrohur e kam / e udhëtimin e tij / asgjë s`e ndal /. (FLATRA NË FJALË).

Pjesa më e madhe e poezive të kësaj poeteje, shpalosin dromca mendimesh të çastit, të cilat në përpunimin artistik të shplosjes së tyre, marrin trajtat e vargut, duke shhpalosur me to, refrenin e ndjesisë individuale të përjetimeve të çastit dhe frymëzimit, që vjen si një burim i brendëshëm dhe i pashterrshëm tani më tek kjo poeteshë.

Kjo për faktin, se ajo tani më po vjen me librin e gjashtë të saj, dhe në vazhdimësi po dëshmon stilin dhe veçantinë e saj krijuese, brenda finesave në varg, duke dëshmuar ndjeshmëri të hollë për mjeshtrinë e artit të bërjes së poezisë.

Duke i lënë hapësirë lexuesit, për një imazh personal për vargun që do të lexojë në vazhdim, do të shkëpusim edhe disa vargje, për ta plotësuar atë që thamë më lart**:** ***/ Këngë e pakënduar / valë e zemrës sime / Në pentagram / dridhjet e shpirtit / Kujtimet / valëzojnë trazirave / Nostalgjia / ra mbi zbrazëtinë / e etjes sime /. (ZBRAZËTIRË).***

Le t'i urojmë suksese dhe ngritje të vazhdueshme, vargut të poeteshës Vera Istrefaj, ashtu siç do t'i dëshironim edhe sukseseve të saj në artin e poezisë.

Zvicër, janar, 2016

***

NOSTALGJI

Në palë të flokut
ta kam fshehur prekjen
e xheloze bëhem
kur e përkëdhel erë e malit.

Gërshetat i kam shprishur
për t'u vënë
kurorën e mallit.

Xhevahir të rrallë
kam prekjen tënde
në palë të flokut
lodruese mbi ballë
***

NË PIKË TË LOTIT

Të lë takim
në pikën e vesës,
në orën e trokitjes së zemrës.

Në pikë të djersës
ia kam mbytur
humbjen e shpresës

Dhe,
në pikë të lotit
kam pritjen për ty
kripëzuar

***

MALL

Jam në pritje.

Tringëllima e telefonit
gurgullimë në veshë.

Çfarë pres?!

Ah,
thirrjen tënde pres.

Nuk di
ç'do të më thuash
pas receptorit, në vesh.

Prej kohësh
më cingëron tringëllima

Mbetur jam në pritje.

Nëse do të më thuash
që bëra gabim
e kuptoj.

S'ka rëndësi ç'do të thuash
veç të mos zgjasë kjo pritje,
kjo tringëllimë e heshtur.

Zhytur jam në punë
e luks për mua janë
mendimet në qetësi.

Ngrije receptorin,
kjo ka rëndësi.

Nuk mund t'i lë gjërat pa emër.

Pas thirrjes tënde
një mendje të hapur do të gjesh
dhe një të tillë zemër

Unë po pres
***

ÇASTE SHTERPË

Sot më trokiti në derë
një ligësi

Lehtas arriti të më ulet
në vatër

Ma cingërrithi
butësinë e shpirtit.

Më është ulur
këmbëkryq
e më zgërdhihet

e pa emra ligësi,
ehhh, veç lotin kam stoli

Thuamë e paemër
ç'do të sjellësh në jetë
se je femër

Do zoti
mbetesh shterpë
me hazdisjen tënde.
***

IKJA E MOSHËS

Filloi vjeshta
të më flasë
me fëshfërimën e gjetheve.

Zogjtë
nxitojnë të prehen
mbi ngjyrat e fundme
të saj

Me gjuhën e pëshpërimave
zogj e gjethe
më flasin.

Ma ka zgjatur dorën
mirësia
si nëna bijve të saj.

Poshtë qerpikëve
një lot kristal
rrjedh pastaj.
***

TRASHËGIMIA

Do ta shurdhoj botën
me heshtjen time.

Dashakeqësit
zvarrë do ti tërheq
gurëve të jetës
thep më thep
të butësisë që kam,

Në ëndërra do tu dal
herë engjëll, herë djall.

Mbretëroj sallon madhështor,
në 49 metra katror.

Rrethuar jam me thjeshtësi
kurora e dashurisë
më ka hijeshi

Fuqi më japin
dy engjëjt,
djemtë e mi
***

ETJE

Shpeshherë
buzët më vrapojnë
drejt rrëfimit
dhe ndalen të kafshojnë
njëra-tjetrën

Heshtje.
Përlotja
më krip plagën e shpirtit

Eshtë mbështjellë
kjo vetmi vrastare
me etjen time
***

DHIMBJE E SHURDHËT

Dhimbjen time
çdo ditë
e ujis me shpresë
ëndërrat
me buzëqeshje.

Në çdo çast
jam vetja
e për zili
s'më zë etja.

Gjurmët e dhimbjes
as bora e sivjetshme

nuk i mbuloi.

Yllin e mëngjesit
strehuar kam në gji
për të më ndriçuar
natën me stuhi
***

DHIMBJES I RRËFEHEM

Lotët e mallit
e kanë kriposur
zjarrin e dhimbjes time,

Etja shkrumbet
shpirtit të plagosur.

Eh,
shpirt-krisje kripëzuar
malli im

Për TY, baba.

Kaq vite shkuan,
prapë pas teje jam

si një fëmijë.

Nuk më vlejnë vitet mbi supe,
për të të harruar,
as hallet e jetës.

Si një fëmijë
para teje kam mbetur.

Nuk është vetëm mall
ajo që më mundon,
është shumë më tepër.

Nuk di
nëse mund t'i vë emer.
mungesës

Me dhimbjen
Si kokërr kripe
në zjarr
po më plas kjo zemër.

Baba…

Ka kohë që nuk të kam vizituar
Prehën e përjetësis tënde

Nuk mundem…

Të kam të gjalle, ketu… ne shpirt…

E ktheva koken sot….kur po udhetoja…
Nga varri yt…

Ti e di …Si të ndaloja….

Kur unë kuvendoj me ty çdo ditë?!

Jetojmë bashkë baba… jetojmë

Bashkë i marrim vendimet…
në vetminë tonë të thellë.

E unë,
Përherë para teje si një fëmijë…
Dhimbjes i rrëfehem
***

LODHUR

Lodhur...lodhur...
Mbi avujt e filxhanit
përdridhet lodhja ime
e trudhembja
zhytet tymit të duhanit

Qerpikët
takojnë sy-enjtjen

Lodhur...lodhur...
Shpirti përpëlitet
udhës së mendimeve,
furisë së ndjesive,
plagosur
halleve pa sosur

***

NË KAFENE "Ulqini"

Në kafene "Ulqini"
kafenë rrufis,
me fijet e zemrës
fjalët i qëndis

Në dritherimë zëri
Vallëzon shpirti

Këtë mëngjes të freskët
dielli prapuar,
me magjinë e vargut
unë duke vallëzuar
***

ASGJË NGA KJO DITË

Në fund të ditës
kuptova se…

Plot një orë
qëndruam bashkë në kafene,
por me kilometra
ishim larg ne.

Vetëm një orë
do të thuash ti,
por e pafundme
ishin ato çaste

plotë zbrazëti.

Folëm,
u pamë
por larg, larg ishim

Në mendje tani më vijnë
perlat në qafë,
të vetmet,
që tek ti shndrijnë.
***

NJË TJETRE

…taka të larta…
…veshje të shtrenjta…

Sa më dhimbsesh!

Tani
shokët po të njohin
cila je,
por nesër…

Nesër do të njohësh shokët
dhe veten….

…kur këmbët t'i kesh përdhe.
***

JAM VETVETJA
(shoqes time)

Me është plagosur shpirti
mikja ime

Ta them se kam arsye të mendoj

Fjala e pathënë
ndodh të vrasë më shumë
se ajo që thuhet

Ajo çfarë është mes nesh
nuk ka vend për te tjerët

Më mirë
ta lëmë siç është
mbase të brishtë
por të kthjellet

Retë e dyshimit, sugjerimit
jashtë qiellit tonë të jenë
ndryshe gjërat mes nesh
ç'siguri do të kenë?

Jam vetvetja mike
edhe në gabime unike

Ta dish, përherë
dikush do të dojë para teje
të më heqë një vlerë

Kam pak të tilla mikja ime
Pak
mbase si të gjithë rreth e qark

Mike
nuk janë vëetimat
ato që ujisin bimët

Eshtë shiu
që rimon mbi to
si lotët e mi sot.

Më është plagosur shpirti
mikja ime
e që t'i them të gjitha
të mos kesh dyshime.

Mendjen e kam ndarë,
por ku e lidha miqësinë
mbeti si një nyje në litar

Këtë nyje do ta vuajmë,
por bashkë

nëse mes nesh
nuk do të gjejë vend
as edhe një ashkë

Më është plagosur shpirti
mike,

por për hir të miqësisë
do ta kaloj dhe këtë dhimbje.
***

MISTER

Kafenë
e pimë apo na piu?

Buzë filxhanëve
u varën shqetësimet tona,
të thëna e të pathëna.

Mes miqsh,
në trajta të ndryshme
shkëmbyem shqetësime,
madje
i bëmë varg
si nusja dikur petkat e pajës

Vargu i shqetësimeve
na ndolli ndjesi
që vargje nuk u bënë,
nuk u bënë poezi,
por u jetuan,
ishin aty.

Duke heshtuar a duke folur
do të na zinte hëna,
por hallemadhja jetë
na thirri
si fëmijën nena.

Kafeja…
e pimë apo na piu?
***

GJURMË E SHI

Udhë pa udhë ky shi
rrugëve të qytetit

Vjen drejt meje
natyrshëm

Në buzë
të çelen puthjet e mia
të padhëna

Nëpër faqe lulojnë
mollëzat e gishtave të mi,
për prekje që s'u bënë
zemra bëhet hi.

Ç'shi i shashtisur
sythe dashurie
duke plasaritur
Një kurore me lule
bashkë qenkan bërë,
anekënd qytetit

fshehur paskan qenë
nga frika e të nxehtit.

Edhe përqafimet
nga trungjet e blirëve
dolën zinxhirëve

I hazdisur ky shi,
i zhuritur paska qenë qyteti,
si unë e ti

Pikë e shiut
lodron buzëve të mia,
qerpikët dritojnë
nga pika e kristaltë
faqeve më kuqëlon
ndjesi e përvaltë.

Eci bashkë me shiun,
udhë pa udhë
nëpër mendime

të lë ty dhe veten
lule të një lëndine

Ky shi…

Shi vjeshte
e zemra me dridhet
nëpër heshtje

ç'shi i shashtisur

sythe dashurie
duke plasaritur.

Sythe të gjorë…

Dëbora e kristaltë
do t'u jetë kurorë…
***

LAKMI E USHQYER

O, sa e madhe
buzëqeshja ime!

Cep me cep të saj
zvarrë ju tërheq
langonj…

Jargët ju shkojnë
tek më përflisni,
duart iu dridhen

Stërkala nga goja juaj
shpërthejnë….

Uf! Gërdi!

E unë, e vogla Verë
si përherë
ju mëshiroj
nëpër buzëqeshje,

që çelur më kanë në buzë
si pranverë
***

DRITIM

Flokëve të dëborës
po më driton shpirti

Mbylli qepallat
ta ndiesh puthjen time

Qepikëve
lëre flokëborën,
ta fshish
mos e zgjat dorën.

Eshtë e lehtë prekja ime,
peshë drithërime

Mbeta flokëborë
me halle mbi kokë
si kurorë
***

THERJE SHPIRTI

Halave të pishës
po më theret shpirti

Zogjtë e paktë
të fundit në shtegëtim

shkelin shpirtin tim

Një ndjenjë më mbëltoi
nën hijen e saj

Medet ç`trazim
ndjeva shpirtit tim
***

DEHJE DËSHIRE

Përkund deti dëshirën time
dallgëve te tij
si nëna foshnjen në gji.

Puhizë pranverore
përflak faqet e mia.

Mbi supe
mantel mbretëror kaltërsia.

Qetë…qetë…qetë…

Qetësisht vrulli nis udhëtimin
nga dejet e mi
në qiell
mbi re.

Ujëdeti dëshirën ma deh.

Pasqyrë rrezore më verbon shikimin

freski kaltërore
më rrëmben mendimin.

Bëhen bashkë
dëshirë e mendim
e udhëdetin marrin
si delfin
***

PRITJE

Trishtil
në pellg të ujit
pa flatra
mbetur kam

Kalimtarët ecin
e ndjesitë e tyre
era i përlan.

Të thatë
ata kanë mbetur,
të tretur
pa ndjesi,
pa dritë në sy.

E unë,
trishtil i mjerë
pres një pranverë.

***

MALL PËR TY

Pershendetje ime
kristal m'u bë në buzë
këtë mengjes të ftohtë.

Buzëqeshja e shikimi
u nisën drejt teje ngrohtë.

Thjesht,
thjesht për të treguar
se jam e je aty,
edhe nëse nuk flasim
kjo nuk ka rëndësi
***

DASHURI E PËRJETSHME

Me puhizën e frymëmarrjes tënde
heq pluhurin
që koha ka vënë në shpirtin tim.

Njëzet vite bashkë
e une prapë,
si atëherë
pres në këtë dimër
një lule-pranvere

Ti,
ma lexon dëshirën
strukur në trurin tim

m'i çel dëshirat-lule,
sythe në shpërthim
***

BUZË DRINAVE

Jam përkundur
mes dy Drinave
në djepin e valëve të tyre,
petalet e lulegjalices
mbulojë fytyre.

Ninullë
këngën e zogut,
aromën e blirit
në palën e flokut.

Në rritje
me veriun,
mjergullën, borën e shiun.

Vrapojnë ditët e mia
e unë prapë
mes dy Drinave.

Dy Drinat dhe unë
prapë aty,
vec valët e tyre
i kam në sy.
***

PËRKUNDJA E ËNDËRRAVE

Shpirti më përkundet
halleve.

Zogu
nuk ma kendon më
këngën e majit.

Aromë e blirëve
është sosur,
shpirti
zog i plagosur.

Në krahë
përkund ëndërrat
e djemve të mi,
vec para gëzimit të tyre
mbetur kam fëmijë.
***

BIJVE TË MI

Vrapuan vitet
u rritët.

Unë,
mbeta nënë e pagjumë.
Meraku në zemër
lule e paemër

Puthjet e mia
janë më të thella
edhe pse në faqe
iu ka çelur “ferra”.

Më merrni në krahë
si dikur juve unë
e dashuria ime,
lumë

Endërrat e mia
kalërojne realitetit

Eh, kjo ndjesi...!

Bijtë e mi,
e pakushtëzuara
e vetmja dashuri.
***

LIGËSI

Ti
që qurravitesh
kofshëve laviresh,
dole zinxhirësh?

Lehjet e tua,
asgjë për mua.

Hidh pluhur, pa problem

guri i çmuar, njësoj vlen

Ti kot, ëndërrat e liga
i ndërsen
***

NGRICA MENDIMESH

U varën mendimet
pemëve te qytetit,

degëve të tyre
u ngrinë

Mbeti koha ngurtësuar,
Kujtimi i akulluar

Gjalica
nuk shihet

Ecim kokëulur
në pritje të diellit
qoftë edhe i acartë
18 dhjetor 2013
***

ÇASTE VJESHTE

Kaq shkujdesur
enden njerëzit rrugëve
të qytetit tim

Gjethet e pemëve
supeve të tyre,
fëshfërijnë

Kjo gjethnajë
supet hapëron

Heshtazi,
pa kuptuar
… ca pika lot…

Rrëmbimthi bien
trotuareve

E supet e njerezve
nën peshën e halleve

Vjedhtazi
veriu fryn

Supet e njerëzve mbledhur,
gjethnaja në fëshfërime…
***

DIKUJT...

Pak më tej vështrimin
hiqja prangat mendjes
mos zijos mendimin
si nje rob të ëndjes

Nëpër gojë
të rrokullisen fjalë
si zaret e ligësisë

Gozhdë e ndryshkur
ke mbetur diku
në trarët e vjetër të shtëpisë.
***

IKJE E DHIMBSHME

(Dedikim për Enkelejda Lapa)

Lot në sy
ke mbetur e dashur
lot që nuk rrokulliset faqeve

Kripësia e tij
ma zjarrmon plagën e shpirtit

Ikja jote…

Si ta quaj…

Asesi…

Ti je ketu,
në qerpikun tim,
lot në sy.

As deti nuk e qas

lotin tim

Në velat e shpirtit
dhimbja për ty
gjithonë në lundrim
***

JO RËNIE

Një jetë duke kafshuar
dhimbje, fyerje...

Nuk po e përtyp dot
edhe pse në sy
nuk më shihni lot

Nëpër dhëmbë mbetet fjalë
që nga buzët nuk mund të dalë

Truri në dilemë:
Kështu,
apo ti lëmë, të flenë?

Le të bien në një shtrat
fyrje e dhimbje
shterpë do të mbeten,
pa emër.

Nuk kanë si ia dalin
të më ulen në zemër!
***

TYMOSJE HALLESH

Më jep një cigare
ta tymosim këtë jetë
plot halle

Verdhëzuar
lulet e shpirtit,
të këputura
këtë vjeshtë të mbrame

Tymnaje trunore
trishtimi
zënë për dore

Lëre hirin
të bjerë
plagëve të shpirtit,
aty
ku ëndërrat e shpresat rrinë
mbytur në nikotinë

Më jep një cigare!
Mos u cudit!

Të pijmë bashkë,
hallet t'i mbysim me tym
t'i japim ca sekonda vetes
në përpëlitje
halleve të jetës.
***

MBI GJETHE VJESHTE

Mbi gjethe vjeshte
plot ngjyra
flutur krahëlehtë
i nisa vargjet

Lumit të Vushtrisë
duke i kundruar
në kopshtin me mollë
kopsht i mrekullisë

Po, po!
Mbi një gjethe vjeshte,
e tek i kundroja
edhe ti mike, heshte

Lashtësia ilire
na kishte zaptuar
zemër e mendje
Vargjet udhëtonin lumit
plot ëndje

Gjethe vjeshte
u bë zemra ime,
shkundur mendimeve

Fantazinë e lashë,
krenaria më shëtiste
harqeve të urës së lashtë

Nëntë harqe...
Ku janë katër të tjerë!
Sot vargjet mbi gjethe-vjeshtë
shumë shpejt
mbi sythe-pranverë
Vushtri, tetor 2014
***

GJURMË FJALËSH

Buzë gotës
mbetën gjurmët e fjalëve
që kurrë nuk u thanë.

Avulli i frymëmarrjes
i vë në dukje,
si e akullt membranë

Mendimet shëtisin trurit
e vështrimi ngrin
mbi këtë mjergull gri

Torturueshëm
di kjo mjegull qytetit,
shpirtit më rri
***

DIMRI

Dimri
përqafoi fuqishëm
brishtësinë e supeve

Peshë e bardhësisë
rëndueshëm
ngrin vështrimet

Pas hapave nëpër qytet
mbetet heshtja,
heshtje që klith
ngricave të shpirtit

Tutje në horizont
ngrirë shpresa

Degëve të blirëve
hallet nxijnë

Stuhisë së shpirtit tim
veç vargu në rrëfim

ABSTRAKSION

Tutje darë e mendimit,
librin e ëndërrave
mos ma shfleto!

S'po i gjej dot një varr
trishtimit
***
IMAZH

Mbi liqe
ngrica e zezë zuri vend

U terruan shpresat

Dridhet zemra
si gjethe vjeshte
furtunave të shpirtit

Po fundosen ëndërrat
***

Ç`TRISHTIM

Kjo mjergull
si mjekra e plakut të moçëm
na është varur shpirtit

Na i ftohu ëndërrat
e na njomi trishtimin

Në dhimbje eshtrash
shtrihet kjo mjergull,
mjegullon vështrimin

ç`trishtim
***

SHPRESË

Buzëqeshjes
mos ia mbyll derën

Lëre të dritojë
nëpër shpresë

Mbi trishtim lëre,
si lule me vesë
***

KUJTIME

Mbi tym mendimi
nje tufe dëborë
flokëve si kurorë

Deshpërimit
noton zemra

E në shpirt mbeten
gjurmë të paemra
***

VJESHTË NË SHPIRT

I kanë ikur gjethet
pemës së shpresës

Lulja zhuritur
mungesës së vesës

Nisur në udhëtim

vjeshta e vonë,
shpirtit të trazuar
***

FLATRA NË FJALË

Le t'i nisin fjalët
pranga për to s'kam

Po më rimon shpirti
si ky shi mbi xham

Vargu flutron
petal më petal

Me rrezet e shpirtit
ngrohur e kam
e udhëtimin e tij
asgjë s'e ndal
***

Ç`TI JAP ETJES?

Shpirti,
kjo letër ku dhembja shkruan

Zemrës
i jep flatra veç gëzimi

Nga mendimi
truri vuan

Më pushton trishtimi

Ç`ti jap etjes?
***

AKULLI I KOHËS

Në skërmitje dhëmbësh
akulli i kohës
më mundon,
e zjarri i zemrës, bubulak
shkrumbon

Sa pak kërkoj nga jeta,
sa pak!

E s`më ofron
asgjë
***

KRISTAL NË SY

Më mbetën sytë
drejt derës

Pres të më vish
si syth i pranverës

Mureve të zemrës
përplaset etja për ty

E portreti yt,

kristal në sy,
imazh
***

NË PRANVERËN
E SHPIRTIT

Livadhet e ndjenjave
më blerojnë
çdo pranverë

Pas cdo dimri
zemra me çel

E pranvera e hershme
bleron shpirtit

Si një kopësht me lule
ku dehemi ne të dy
***

ZBRAZËTIRË

Këngë e pakënduar
valë e zemrës time

Në pentagram
dridhjet e shpirtit

Kujtimet
vallëzojnë trazirave

Nostalgjia,
ra mbi zbrazëtinë
e etjes sime
***

IMAZH NË IKJE

Pendë të argjendta
zogjtë e shpirtit

Edhe kalimin dembel
nga teli në tel

Gjalica rëndon
nën të bardhin mantel

Dimri po rrëshqet
duke mbretëruar
nën këmbë tona
***

ACAR

Kjo vjeshtë
la gjurmë në shpirtin tim

Etjen
nuk ma shoi
shija frutore

E tani,
etjen ma ngriu në buzë

një flokëz dëbore

Një putje e acartë
ngriu qiellit,
puthje e kristaltë
***

KRAHASIM

Stinën e mjergullës
të gjatë e pati ky vit,
mjaft të gjatë

E ftohtësinë
lak në fyt.

Tymnajë
në kokat e njerëzve,
tymnajë.

Ç`ti japim qiellit
në këtë etje shekulli?

Përpëlitet etja
në funde oqeanore,
e tymnaja jonë
na tërheq për dore.

▼▼▼▼▼▼▼▼▼

Përmbajtja e librit:

Fjala e redaktorit.....5
NOSTALGJI.....11
NË PIKË TË LOTIT……..……...…..12
MALL…….....13
ÇASTE SHTERPË 15
IKJA E MOSHËS.....16
TRASHËGIMIA.....17
ETJE ……..…..18
DHIMBJE E SHURDHËT.....19
DHIMBJES I RRËFEHEM……20
LODHUR.....23
NË KAFENE " Ulqini".....24
ASGJË NGA KJO DITË.....25
NJË TJETRE.....26
JAM VETVETJA.....27
MISTER……30
GJURMË E SHI……31
LAKMI E USHQYER……..…34
DRITIM.....35
THERJE SHPIRTI.....36
DEHJE DËSHIRE……37
PRITJE……38
MALL PËR TY……39
DASHURI E PËRJETSHME……..40
BUZË DRINAVE.....41
PËRKUNDJA E ËNDËRRAVE.....42
BIJVE TË MI……43
LIGËSI……..…..44

NGRICA MENDIMESH……..45
ÇASTE VJESHTE 46
DIKUJT.....47
IKJE E DHIMBSHME.....48
JO RËNIE.....49
TYMOSJE HALLESH.....50
MBI GJETHE VJESHTE.....51
GJURMË FJALËSH.....53
DIMRI.....54

Stuhisë së shpirtit tim veç vargu në rrëfim

ABSTRAKSION.....56
IMAZH.....57
Ç`TRISHTIM.....58
SHPRESË.....59
KUJTIME.....60
VJESHTË NË SHPIRT.....61
FLATRA NË FJALË.....62
Ç`TI JAP ETJES?.....63
AKULLI I KOHËS.....64
KRISTAL NË SY.....65
NË PRANVERËN E SHPIRTIT.....66
ZBRAZËTIRË.....67
IMAZH NË IKJE.....68
ACAR.....69
KRAHASIM.....70

▼▼▼▼▼▼▼▼

Botime të autores:

1 - “Shiu i fundit” -Poezi

2 - “ Nënqeshja e ëmbël”-Poezi

3 - “Në akuj digjem” -Poezi

4 - “U jepem udhëve”-Poezi

5 - “Qielli i shpirtit tim”-Poezi

Vera Istrefaj
VESË SHPIRTI
Faqe; 74
Madhësia: 14 X 21
Shtëpia botuese: **Metafora**, Zvicër, 2016